

## **SHPALLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE, LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL**

### **Specialist ne Sektorin e Analizes dhe Studimeve Kategoria e pagës III-b**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut VI dhe VII, të Vendimit nr. 143, datë 12/03/2014, të Këshillit të Ministrave, Autoriteti i Konkurrences shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit ne sherbimin civil për pozicionin:

- Specialist ne Sektorin e Analizes dhe Studimeve - Kategoria e pagës III-b

**Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës se pranimit ne sherbimin civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim ne sherbimn civil) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave:**

**29 dhjetor 2014**

***\*Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për grupin e pozicioneve si më sipër është:**

Monitorimi dhe analizimi i kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lire dhe efektive në Shqipëri, në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe akteve ligjore dhe nën ligjore të lidhura me fushën e konkurrencës.

Realizimi i raporteve kërkimore mbi analizen ekonometrike të fenomeneve dhe praktikave antikonkurrense, mbështetur mbi metodologjitë dhe praktikat me të mira në këto fushë.

### **I-Lëvizja paralele**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-b),
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor", Fakulteti i Ekonomisë. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1-vit.

#### **2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës;

- c) fotokopje të librezës;

- ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29 dhjetor 2014.**

### 3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **05.01.2015**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrences ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### 4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike
- c) Konkurrimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 ” Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombetare e Konkurrences, Kodin e Procedurave
- d) **Për më shumë: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)**

### 5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

## 6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti I Konkurrences do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

## II- Pranimi ne sherbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit ne sherbimin civil.

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21 te ligjit nr 152/2013 “Për nepunesit civil”.*

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit ne sherbimin civil

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” ne degen e Ekonomise. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1-vit.
- c) Te zoteroje gjuhen angleze dhe nje gjuhe e dyte e vendeve te BE perben avantazh.
- d) Te zoteroje aftesi te punes ne grup
- e) Pervoja ne administraten publike perben avantazh.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës dhe listes se notave;

c) fotokopje të librezës se punes;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

d) Vertetimi gjendjes gjyqesore

dh) Numer kontakti dhe adrese vendbanimi

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me poste ose dorazi, *brenda datës 29.12.2014*, në Autoritetin e Konkurrences me adrese: Rruga “Sami Frasheri”, kati IV. Nr.4.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit ne sherbimin civil , do të marrin informacion në faqen e Autoritetit te Konkurrences, për fazat e mëtejshme të kesaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit te Konkurrences duke filluar nga data 07.01.2015.